

Asambleja Kombëtare e BSPSH-së është organi më i lartë vendimarrës pas Kongresit të BSPSH. Numri i përgjithshëm i anëtareve të saj është 101 anëtarë.

Të drejtën e anëtarit të Asamblesë së BSPSH-së e kanë drejtuesit e seksioneve të sindikatave rajonale, federative dhe organeve qendrore të BSPSH-së, sipas kriterëve të mëposhtme:

1. 45 mandate për sindikatat federative sipas realizimit të shlyerjes së detyrimeve të kontributit sindikal.

2. 45 mandate për sindikatat rajonale sipas realizimit të përfaqësueshmërisë më të madhe me kontrata të nivelit të dytë;

3. 11 mandate për organet qendrore të BSPSH-së: Presidenti, sekretariati, forumet dhe departamentet e saj.

Ndjekja dhe zbatimi i kriterëve të mësipërme bëhet me propozim të Sekretariatit dhe vendimeve të Presidentit, i cili sipas statutit ka të drejtë që mbas kongresit të bëjë konstituimin e anëtarëve të asamblesë, sipas kriterëve të mësipërme.

Institucioni i Presidentit me propozim të Sekretariatit të BSPSH-së dhe në konsultim me Komisionin e Interpretimit dhe Zbatimit të Statutit ka të drejtë të bëjë rivlerësime të mandateve të shpërndara në strukturat federative dhe ato rajonale në bazë të kriterëve të përcaktuara në pikën a dhe b të këtij neni.

Punimet e Asamblesë drejtohen nga Presidenti, nga drejtuesi i Federatës më të përfaqësuar dhe drejtuesi i prefekturës më të përfaqësuar.

Përbërja e Asamblesë Kombëtare miratohet në Kongresin e BSPSH-së. Asambleja zakonisht thirret një herë në dy vjet. Jashtë radhe ajo mund të mbledhet me propozim të Këshillit Kombëtar.

Mandati i anëtarit të Asamblesë është i vlefshëm për atë kohë sa drejtuesit sindikalë ruajnë funksionet e mësipërme.